

VENDIM
Nr. 93, datë 27.3.2017

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN LEZHË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË PËR SHKAK TË MBARIMIT TË MANDATIT TË DEPUTETIT Z. ARMANDO PRENGA

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 27.3.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar Biba	kryetar
Hysen Osmanaj	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në Qarkun e Lezhës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të mbarimit mandatit të deputetit të z. Armando Prenga.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 4, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr.735/1 prot., datë 27.2.2017, drejtuar KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, ka njoftuar krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Armando Prenga, deputet i zonës zgjedhore, qarku Lezhë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit të deputetit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreu II, pika 3, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 64, datë 20.3.2017, ka vendosur të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, z. Kastriot Filip Piroli, pasi kandidati nuk depozitoi brenda afatit formularin e vetëdeklarimit.

Me shpalljen e moszgjedhshmërisë si deputet i Kuvendit, të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, z. Kastriot Filip Piroli, rezulton se lista e kandidatëve të Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, ka shteruar. Sipas nenit 164, pika 4, të Kodit Zgjedhor, në rast se lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni ka shteruar, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë. Në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013, Partia Socialiste ka qenë pjesëtare e Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane, regjistruar në KQZ, me vendimin nr. 282, datë 4.5.2013, “Për regjistrimin e Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane, si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin 2013”.

Referuar vendimit të Kolegjit nr. 35, datë 2.8.2013, Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane ka fituar 3 mandate, Partia Socialiste ka fituar 2 mandate dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka fituar 1 mandat. Sipas nenit 163/2 të Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme të secilës parti të koalicionit, pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë tek të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të

mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse për koalicionin në fjalë.

SHPËRNDARJA E MANDATEVE PËR KUVENDIN BRENDË KOALICIONIT ALEANCA
PËR SHQIPËRINË EUROPIANE, NË ZGJEDHJET E VITIT 2013

Qarku Lezhë

Mandate	1	2	3	4	5	6	7
Parti/pjesëtues	1	3	5	7	9	11	13
PS	26433	8811	5287	3776	2937	2403	2033
LSI	8820	2940	1764	1260	980	802	678
PSD	1017	339	203	145	113	92	78
PBDNJ	658	219	132	94	73	60	51
PDS	573	191	115	82	64	52	44

Herësit e përfutur nga çdo pjesëtim, renditen, sipas tabelës më lart, nga ku rezulton se brenda koalicionit, partia me herësin më të madh (2940) është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Në këto kushte, mandati i ndërprerë i z. Armando Prenga i kalon Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Lezhë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Sipas listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore qarku Lezhë, të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, rezulton se pas znj. Monika Ramazan Kryemadhi kandidati i radhës është kandidati me numër rendor 2 (dy), z. Petrit Preng Gjoni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Petrit Preng Gjoni, depozitoi formularin e vetëdeklarimit në KQZ si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, deputet i Kuvendit.

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, KQZ-ja bëri publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit dhe verifikimin e të dhënave në këtë formular, si dhe kërkoi informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin.

Sipas informacionit të ardhur me shkresën nr. 2452, datë 24.3.2017, nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, në KQZ, rezulton se z. Petrit Preng Gjoni, kandidat për deputet në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Lezhë, është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Petrit Preng Gjoni, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Lezhë, i renditur me numër rendor 2 (dy), z. Petrit Preng Gjoni.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim Qarku Lezhë, z. Petrit Preng Gjoni.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Denar Biba